

BURIMET PËR GATISHMËRI NE RASTE EMERGJENCASH

FEMA për Fëmijët

<http://www.fema.gov/kids/>

FEMA për Prindërit & Mësuesit

<http://www.fema.gov/kids/teacher.htm>

Fushata të Jesh Gati

<http://www.ready.gov/>

Instituti i Menaxhimit të Emergjencave
(Kursi i Studimeve të Pavarura)

<http://www.fema.gov>

Citizens Corps

www.citizenscorps.gov

Gati apo Jo?

www.readyregion.org

Kryqi i Kuq Amerikan

www.redcross.org

Informacioni i Kontaktit

215-400-4710
215-400-4711 (fax)

Safetynet@philasd.org

Kryeinspektor, Myron Patterson
Shef i Sigurisë së Shkollës

Brendan Lee
Drejtor Ekzekutiv,
Siguria e Shkollës

Tricia London
Menaxhimi i Emergjencave
Koordinimi



Për informacione dhe dokumenta të tjerë të përkthyer
në Gjuhën Shqipe, ju lutemi vizitoni uebsajtin:
www.philasd.org/language/albanian

Drejtoria Arsimore e Filadelfias Zyra e Sigurisë të Shkollës

Gatishmëria & Menaxhimi i Emergjencave

215-400-SAFE



PRITSHMERITE E SIGURISË

Udhëzojmë
Prindërit për
Emergjencat &
Sigurinë

PËRPARA

LIDHJA ME PRINDIN

Vendi më i sigurtë për fëmijën tuaj, në raste incidentesh të mëdha në shkollën e tij. Ju lutemi përditësoni:

- ✓ Personi që duhet Kontaktuar në raste Emergjencash
- ✓ Numrat lokalë dhe në distancë për raste Emergjencash

Planifikimi për Sigurinë

Secila shkollë ka një Plan të individualizuar për Sigurinë e Shkollës për të siguruar që **GJITHË** nxënësit janë të sigurtë. Kontrolloni në shkollën tuaj:

- Pikat e Grumbullimit në Raste Emergjencash
- Vendet e Evakuimit dhe Zhvendosjeve
- Procedurat e Përgjithshme për Përgjigje ndaj Emergjencave

Menaxhimi i Vizitorëve

TE GJITHË vizitorët kërkohen të regjistrohen në vendin e pritjes dhe të pajisen me kartën e vizitorit. Ju lutemi jeni të përgatitur për:

- Kartën shtetërore të Identifikimit
- Emri i Nxënësit dhe
- Qëllimi i Vizitës

**JU LUTEMI KUJTOHUNI
TE SHENONI OREN
KUR JU LARGOHENI NGA
SHKOLLA**

PRITSHMERITE E SIGURISË

GJATE

**PËR SIGURINË E TE GJITHË
NXENESVE, GJATE NJË INCIDENTI NE
SHKOLLE, PRINDËRIT:**

- Inkurajohen **TE MOS** raportojnë fillimisht në shkollë
- Kërkohe bashkëpunimi me nëpunësit e shkollës dhe personelin e emergjencisë

Procedurat e Përgjithshme për Përgjigje ndaj Emergjencave

Ulu, mbulou dhe qëndro: Nxënësit shkojnë drejt mureve të brendshme, ulen në përdhe, mbulojnë sytë duke mbështetur fytyrën me në të dy krahët, dhe qëndrojnë në këtë pozicion deri në udhëzimet e tjera.

Evakuimi: Nxënësit drejtohen përmes rrugës më të shkurtër dhe më të sigurtë. Kjo përdoret kur konditat jashtë shkollës janë më të sigurta se ato brenda shkollës

Evakuimi në të kundërt: Nxënësit lëvizin sa më shpejt që është e mundur, përsëri në ndërtesën e shkollës. Kjo përdoret kur konditat brenda shkollës janë më të sigurta se ato jashtë shkollës

Mbyllja me çelës - Të gjitha pikat hyrëse kyçen. Nxënësit, largohen menjëherë nga korridorët dhe vendosen tek klasa më e afërt e mundëshme. Ndalohen hyrjet dhe daljet nga shkolla.

Vend-strehimi: Nxënësit, largohen menjëherë nga korridorët dhe vendosen tek klasa më e afërt e mundëshme, ose në një vend të caktuar.

PAS

Prindi/Kujdestari/Fëmija Ribashkimi

Në rastet kur incidentet në shkollë, kërkojnë largimin me urgjencë të nxënësve, do të bëhen të gjitha përpjekjet për të kontaktuar prindërit dhe/ose kujdestarët

Kur autorizohen nga Drejtoria Arsimore, ose Nëpunësit e Sigurisë Publike, personeli i shkollës do të fillojë **me rregull** t'i dorëzojë nxënësit tek prindërit, ose/dhe kujdestarët

Në mënyrë që nxënësit t'u dorëzohen prindërve, ose personit të kontaktit në raste Emergjencash ata duhet:

- Listohen në Listën e Kontaktit në Raste Emergjencash (EH-4/Blue Card) **dhe**
- Paraqesin kartën shtetërore të identifikimit të personeli i shkollës